

PHILIPS

Boks me valë

S4405



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

I	E rëndësishme	2
	Siguria	2
2	Boksi me valë	3
	Hyrje	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje	3
3	Fillimi	4
	Karikimi i baterisë së brendshme	4
	Vendosja e baterive të mikrofonit	4
	Vendosja e kartës micro-SD	5
4	Ndezja/fikja	5
5	Përdorimi i pajisjeve me Bluetooth	6
6	Modaliteti i kartës micro-SD	7
7	Bashkimi i zërave me një burim audio	7
	Regjistrimi	7
8	Informacione për produktin	8
9	Njoftim	8
	Pajtueshmëria	8
	Kujdesi për mjedisin	8
	Deklarata FCC	9
	Njoftim për markën tregtare	9

I E rëndësishme

Siguria



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij produkti.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij produkti.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin mbi pajisje të tjera elektrike.
- Mbajeni këtë produkt larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.

- Instaloheni sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehtësie si për shembull radiatorë, pajisje ngrohjeje, soba, ose pajisje të tjera që prodhojnë nxehtësi (përfshirë edhe amplifikatorët).

- Lexoni dhe zbatoni këto udhëzime.
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme anembanë këtij produkti për ajrim.
- Vetëm personeli i kualifikuar duhet t'i bëjë riparime. Riparimet kërkohen kur produkti dëmtohet në ndonjë mënyrë, si për shembull kur kordoni ose spina e energjisë dëmtohet, derdhen lëngje ose rrëzohen objekte brenda produktit, kur produkti ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, kur nuk punon si duhet ose kur rrëzohet.
- Përdorni vetëm pjesë/aksesorë që janë specifikuar nga prodhuesi.
- Përdorni furnizim energjie vetëm siç tregohet në këtë manual.
- Shkëputeni produktin gjatë stuhive me vetëtima ose kur nuk përdoret për periudha të gjata.
- Ky produkt nuk duhet të ekspozohet asnjëherë ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi produkt (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
- Aty ku spina e energjisë të adaptorit direkt Plug-in përdoret si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.
- Mos e përdorni këtë produkt pranë ujit.

2 Boksi me valë

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/welcome.

Hyrje


Me këtë boks dhe mikrofon, ju

- mund të dëgjoni audio nga një pajisje me Bluetooth,
- mund të dëgjoni audio nga një kartë micro-SD,
- mund të regjistroi me një të prekur në kartën micro-SD.


Çfarë ka në kuti

Ju lutemi kontrolloni me kujdes se vërtetoni se në paketim ndodhet:

- Boksi me valë
- Mikrofonin me valë
- Kablli USB
- Manuali i përdorimit
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë



Përmbledhje



- ① Mabajeni shtypur për 2 sekonda për ta ndezur ose fikur.
- ② Shtypeni për të filluar ose ndaluar regjistrimin e audios si nga mikrofonin me valë, ashtu edhe nga boks.
- ③ Shtypni për të zgjedhur burimin Bluetooth ose karta micro-SD.
- ④ Shtypni për të rregulluar volumen.
- ⑤ Shtypni për të luajtur ose ndaluar.
Shtypni dy herë për të kaluar te kënga tjetër.
- ⑥ **Porta e karikimit micro-USB**
- ⑦ **Vendi i kartës micro-SD**
- ⑧ **Kapaku i pjesës së baterisë**
- ⑨ **Çelësi i energjisë së mikrofonit**

3 Fillimi

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


Karikimi i baterisë së brendshme

Boksi vihet në punë nga një bateri e brendshme e karikueshme.



Shënim

- Karikojeni plotësisht baterinë e brendshme para se ta përdorni.




Lidhni kabllin USB midis prizës micro-USB në boks dhe një prize USB në kompjuter ose karikues.

Treguesi LED (Energjia)

E kuqe që pulson	Po karikohet ndërsa është i fikur
E kuqe solide	Është karikuar plotësisht ndërsa është i fikur
Pulson me radhë në ngjyrë të kuqe/jeshile	Po karikohet ndërsa është i ndezur
Jeshile solide	Është karikuar plotësisht ndërsa është i ndezur

Vendosja e baterive të mikrofonit


- 1 Hapni kapakun e pjesës së baterive.
- 2 Vendosni 2 bateri alkaline AAA (nuk janë dhënë) me polaritetin e duhur.
- 3 Mbylleni kapakun e pjesës së baterive.



AAA x 2


Vendosja e kartës micro-SD

- 1 Hapni kapakun e vendit të kartës.
- 2 Vendosni një kartë micro-SD (nuk është dhënë) me kunjin të drejtuar poshtë derisa të dëgjoni një klikim. Pastaj mbylleni kapakun e vendit të kartës.




4 Ndezja/fikja

- 1 Mbani shtypur  për 2 sekonda për ta ndezur ose fikur boksën.



- 2 Çojeni lart çelësin e energjisë për ta ndezur mikrofonin.
Distanca e mikrofonit deri në 5 m




5 Përdorimi i pajisjeve me Bluetooth

Me këtë boks mund të dëgjoni audio nga pajisja juaj me Bluetooth.



Shënim

- Sigurohuni që funksioni Bluetooth është i aktivizuar në pajisje.
- Mbajeni larg nga çfarëdo pajisje tjetër elektronike që mund të shkaktojë interferencë.

- 1 Mbani shtypur  për 2 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth.



- 2 Zgjidhni "Philips S4405" në listën e Bluetooth në pajisje.
 - ↳ Nëse shfaqet një mesazh që kërkon leje për lidhjen me Bluetooth, konfirmojeni.
 - ↳ Nëse kërkohet fjalëkalim, formoni 0000 dhe pastaj konfirmojeni.
 - ↳ Boksi pulson kur lidhet me sukses.



Treguesi LED (Bluetooth)

Pulson ngjyrë blu	Çiftimi me Bluetooth
Blu solide	Bluetooth është lidhur


Shënim

- Për ta shkëputur, çaktivizoni lidhjen e Bluetooth me këtë produkt në pajisjen tuaj ose shtypni  përsëri për të kaluar në modalitetin e kartës micro-SD.

6 Modaliteti i kartës micro-SD

Mund të dëgjoni audio nga një kartë micro-SD që ruan skedarë audio.

Shtypni  vazhdimisht për të zgjedhur burimin micro-SD. Treguesi LED i Bluetooth do të fiket për luajtjen automatike të micro-SD.



7 Bashkimi i zërave me një burim audio

Shënim

- Për të parandaluar interferencën e mikrofonit, mos e tregoni mikrofonin direkt te boks.


Duke përdorur këtë mikrofon me valë, mund ta bashkoni zërin me një burim audio.

Regjistrimi

Në modalitetin e Bluetooth, shtypni  për të filluar ose ndaluar regjistrimin.

Treguesi LED (REC)

E kuqe që pulson	Gabim (nuk është futur kartë micro-SD ose karta është plot)
E kuqe solide	Duke regjistruar



8 Informacione për produktin

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Informacione të përgjithshme

Furnizimi me energji:	5 V = 1,5 A
Drajveri i boksit	1.5"
Koha e karikimit (Boksi)	2,5 orë
Koha e luajtjes	6 orë
Bateri e brendshme litiumi (Boksi)	3.7V, 1500 mAh
Përmasat (Boksi)	105 x 105 x 38 mm
Pesha (Boksi)	250 g

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	V4.2
Rrezja e Bluetooth	10 m / 32.1 ft

9 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga **MMD Hong Kong Holding Limited** mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur produktin.

Pajtueshmëria



Këtu, **MMD Hong Kong Holding Limited** deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaraten e konformitetit në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqui rregullat

vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.



Vetëm për REFERENCË

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Deklarata FCC

Kjo pajisje i përmbahet pjesës 15 të rregullave FCC. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar.

Paralajmërim: Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Shënim: Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC.

Këto limite janë bërë për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një ambient banimi.

Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferenca në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme: (1) Ndryshoni orientimin ose lëvizjen e antenës. (2) Largoni distancën me pajisjes dhe marrësit. (3) Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi. (4) Konsultohuni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

Deklarata e paralajmërimit për RF

Pajisja është vlerësuar se i përmbush kërkesat e përgjithshme të ekspozimit RF. Kjo pajisje mund të përdoret në kushte portative ekspozimi pa kufizime.

Njoftim për markën tregtare



Fjala dhe logot[®] janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga **MMD Hong Kong Holding Limited** bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.



Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

